



An EU funded project managed by the  
European Union Office in Kosovo



## Projekti i BE-së “Mbështetje Profesioneve të Lira Ligjore dhe Odës së Avokatëve”

Një **projekt unik**: për herë të parë të gjitha profesionet e lira ligjore dhe MD-ja ekzaminohen dhe mbështeten si individualisht poashtu dhe përmes një qasje të përgjithshme, e cila merr parasysh kornizën e tyre ligjore, kapacitetet institucionale dhe implikimet për funksionimin e gjyqësorit.

### ➤ Objektiva Kryesore e Projektit

**Përforcimi I Gjyqësorit duke përforcuar profesionet e lira Ligjore** (avokatët, noterët, përmbauesit privatë, ndërmjetësuesit, administratorët e falimentimit) **dhe Odën e Avokatëve**

### ➤ Qëllimi i Projektit

Funksionalizimi i plotë i sistemit të profesioneve të lira ligjore duke përforcuar:

- **Departamentin për Profesionet e Lira Ligjore**, dhe
- **kapacitetet e profesioneve të lira ligjore** (avokatët, noterët, përmbauesit privatë, ndërmjetësuesit, administratorët e falimentimit) **si dhe të Odës e Avokatëve**.

### ➤ Përfituesit

- Departamenti për Profesionet e Lira Ligjore (PLL) në MD,
- 5 Profesionet e Lira Ligjore dhe organet e tyre:
  - Avokatët dhe Odën e Avokatëve të Kosovës (OAK)
  - Noterët; Odën e Noterëve
  - Përmbauesit Privatë (PP-të); Odën e PP-ve
  - Ndërmjetësuesit/Qendat e Ndërmjetësimit
  - Administratorët e Falimentimit.

### ➤ Palë tjera Kyçe të Interesit/grupe tjera të synuara:

- Këshilli Gjyqësor I Kosovës/ Gjykatësit
- Këshilli Prokurorial I Kosovës / prokurorët
- Instituti Gjyqësor I Kosovës
- Agjencia Kadastrale e Kosovës
- Agjencia për Regjistrim Civil e Kosovës

### ➤ Nevojë për koordinim dhe bashkëpunim me projekte dhe donatorë tjerë të numërta.

### ➤ Rezultatet kyçe

- Përmirësimi I kornizës ligjore për PLL-të është mbështetur, vetëdijësimi në lidhje me PLL-të dhe koordinimi në mesin e palëve relevante të interesit dhe publikut janë rritur
- Sistemet për Noterët, Përmbauesit Private, Ndërmjetësuesit dhe Administratorët e Falimentimit janë përforcuar
- Departamenti për Profesionet e Lira Ligjore është plotësisht funksional
- Departamenti për Profesionet e Lira Ligjore është plotësisht funksional
- Kapaciteti I avokatëve dhe Odës së Avokatëve është përforcuar



- **Fushat e Projektit, ndërlidhet me Politikat e BE-së dhe temat e BE-së:**
  - Politika Gjyqësore; Fusha e Drejtësisë, Lirisë dhe Sigurisë
  - Reforma e Administratën Publike
  - Tregu i Brendshëm
  - Mbrojtja e Konsumatorit
  
- **Rëndësia e secilit PLL dhe Departamentit të MD-së për PLL-të**
  - **Departamenti I MD-së për PLL-të:** mbikëqyr funksionimin siç duhet të PLL-ve; krijojnë dhe zbatojnë politika për PLL-të, dhe efikasiteti i përgjithshëm i gjyqësorit;
  - **Avokatët:** ofrojnë shërbime ligjore ndaj të cilave të gjithë personat do të kenë qasje efektive; lehtësojnë një administrim efektiv dhe efikas të drejtësisë; kontribuojnë në cilësinë e vendimeve gjyqësore;
  - **Noterët:** sigurojnë siguri më të madhe ligjore për qytetarët dhe bizneset; përforcojnë sigurinë ligjore për palët e treta dhe kreditorët;
  - **Përmbauesit Privatë:** ndërlidhje direkte e rolit të tyre dhe kushtit për një gjykim të drejtë (të parashikuar nga neni 6/KEDNj) dhe me besimin e publikut në gjyqësor
  - **Ndërmjetësuesit:** figura të rëndësishme në përmirësimin e qasjes në drejtësi, asistimin e qytetarëve në mënyrë reale për të mbrojtur të drejtat e tyre ligjore
  - **Administratorët e Falimentimit:** figura të rëndësishme në i) dalja nga tregu e bizneseve të falimentuara, ii) **Ri-organizimin e bizneseve** të tilla, dhe iii) në mbrojtjen e interesave të kreditorëve dhe qytetarëve.
  
- **Qasja Strategjike e Projektit**
  - Qasje e adaptuar sipas nevojës për MD-në dhe secilin PLL, në nivel legjislativ, institucional dhe praktik;
  - Marrja parasysh e veçantive/nevojave të secilit PLL dhe karakteristikave të tyre të përbashkëta;
  - Përshtatja e standardeve/praktikave më të mira relevante Evropiane kornizës së Kosovës;
  - Mbështetje për zhvillim efektiv institucional dhe ngritje të kapaciteteve për MD-në dhe OLL-të
  - Punë për përforcimin vetëdijesimit të publikut/degëve të tjera të drejtësisë për rëndësinë e PLL-ve për sundimin e ligjit dhe rritjen ekonomike të Kosovës;
  - Punë për Vlerësimin e Nevojave për Trajnim, Korrikulat (programet) e trajnimit, Sesionet e Trajnimit
  - Konsultim dhe koordinim me përfituesit dhe ZBE;
  - Bashkëpunim dhe koordinim I donatorëve;



## Komponentët dhe Aktivitetet e Projektit

### ➤ **KOMPONENTI 0: Qasja Sistemike**

- **0.1:** Rishikim i kornizës ligjore ku të jetë e nevojshme, përfshirë legjislacionin dytësorë (aktet nënligjore), për avokatët, noterët, përmbaruesit, ndërmjetësuesit dhe administratorët e falimentimit
- **0.2:** Zhvillimi i një programi të zbulimit të talenteve për studentët e juridikut
- **0.3:** Ndërmarrja e analizave të nevojave përsa i përket ndërlidhjes së bazave të të dhënave të profesioneve të lira ligjore me institucionet e tjera relevante
- **0.4:** Mbështetja e vetëdijes institucionale në mesin e PLL-ve dhe ndërmjet këtyre të fundit dhe palëve relevante të interesit (ato institucionale, të shoqërisë civile dhe të sektorit privat)
- **0.5:** Mbështetja e informimit të publikut dhe aktiviteteve të vetëdijesimit (AKTIVITET I RI)

### ➤ **Komponenti 1: Sistemet për Noterët, Përmbaruesit Private, Ndërmjetësuesit dhe Administratorët e Falimentimit janë përforcuar;**

- **1.1:** Mbështetje zhvillimit institucional për profesionet e lira ligjore, p.sh duke zhvilluar standarde profesionale dhe etike për anëtarët e tyre dhe duke i zbatuar këto standarde përmes procesit të disiplinës në pajtueshmëri me praktikat më të mira ndërkombëtare
- **1.2:** Zhvillim i mëtejshëm i qendrave të ndërmjetësimit
- **1.3:** Themelimi i një Dhome/Shoqate të Administratorëve të Falimentimit (AKTIVITET I RI)
- **1.4:** Ndërmarrja e një Analize të Nevojave për Trajnim për profesionet e lira ligjore dhe rishikimi i korrikulës së trajnimit për të gjitha profesionet e lira ligjore, duke përfshirë modulet e ligjit tregtar dhe të ligjit për familjen.
- **1.5:** Ndërmarrja e sesioneve të specializuara trajnuese për të gjitha profesionet e lira ligjore me një fokus në qasjen TeT (Trajnimin e Trajnerëve)

### ➤ **Komponenti 2: Departamenti për Profesionet e Lira Ligjore është plotësisht funksional;**

- **2.1:** Futja dhe zhvillimi i sistemit të monitorimit për të matur performancën e profesioneve të lira ligjore
- **2.2:** Angazhimi i OShC-ve për një monitorim vjetor të perceptimit të qytetarëve në lidhje me funksionalitetin e PLL-ve (AKTIVITET I RI)
- **2.3:** Futja dhe zhvillimi i një koncepti trajnimi për profesionet e lira ligjore
- **2.4:** Zhvillimi i mëtejshëm i një sistemi liçensimi në pajtueshmëri me Standardet të BE-së



An EU funded project managed by the  
European Union Office in Kosovo



- **2.5:** Përditësimi i bazave aktuale të të dhënave dhe zhvillimi i atyre të reja për kandidatët për provime dhe liçensim në lidhje me profesionet e lira ligjore
- **2.6:** Projektimi i rrjedhës së punëve për departamentin
- **2.7:** Ngritja e kapaciteteve për të gjithë stafin e departamentit
  - **Komponenti 3: Kapaciteti i Odës së Avokatëve është përforcuar;**
- **3.1:** Asistimi i OAK-së në planifikimin strategjik
- **3.2:** Përforcimi i kapaciteteve të stafit të OAK-së, në veçanti stafit të tij administrativ
- **3.3:** Zhvillimi i një analize të nevojave për trajnim të avokatëve në Kosovë
- **3.4:** Zhvillimi i një sistemi të qëndrueshëm për TeT
- **3.5:** Projektimi i një sistemi trajnimi duke përfshirë doracakë për trajnuesit, kritere përzgjedhjeje, kritere për vlerësimin e performancës për të vlerësuar trajnimet dhe trajnuesit
- **3.6:** Organizimi i sesioneve trajnuese, për avokatë, praktikantë dhe palë tjera të interesuar (p.sh kandidatët për provimin e avokaturës/jurisprudencës) në pajtueshmëri me praktikat më të mira ndërkombëtare në ofrimin e trajnimeve ABVL (Arsimim Bazik i Vazhdueshëm Ligjor)